



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.06.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën 1 – 31 korrik 2019;
2. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 1 – 19 korrik 2019;

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Zëvendëskryetare e Kuvendit
Nyslim Murizi -	Zëvendëskryetar i Kuvendit
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Nimet Musai -	Kryetar i Grupit Parlamentarë të Pavarur
Rudina Hajdari -	Kryetare e Grupit Parlamentarë Demokrat / Kryetare e Komisionit për Integrimin European
Enver Rroshi -	Kryetar i Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Fatjona Dhimitri -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mungojnë:

Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Arben Ahmetaj -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave

Marrin pjesë:

Mimoza Pano -	Drejtoreshë e Shërbimit të Seancës Plenare
Mimoza Arbi –	Drejtoreshë e Shërbimit Juridik

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Hapim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve me këtë rend dite: miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën 1- 31 korrik 2019, si dhe miratimi i kalendarit 3- javor të punimeve të Kuvendit deri në fund të muajit korrik.

Besoj se me këto jeni njohur në rrugë elektronike. Sigurisht, projektprogrami mbaron në datën 11 korrik, por, duke pasur parasysh se javën e ardhshme nuk do ta zhvillojmë seancën plenare, për arsye të angazhimeve zgjedhore, u mendua që të hartohet një program i shkurtër për gjithë muajin korrik. Në zbatim të këtij projektprogrami, është hartuar edhe projektkalendari, të cilin e keni të gjithë para.

Projektprogrami përfshin të gjitha çështjet e depozituara në Kuvend si projektligje, dekrete për shqyrtim, projektvendime, raportime, kërkesa, shkarkime e të tjera.

Deri tani kanë mbetur pa raportuar në Kuvend institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Këshilli i Ministrave për gjendjen e shërbimit civil, Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, si dhe pritet të depozitohet edhe raporti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Të tria institucionet, që kanë mbetur pa raportuar, janë përfshirë në projektkalendar, kështu që kërkoj nga komisionet përgjegjëse që të përshpejtojnë punën për të mbyllur raportimet brenda afateve kalendarike ose projektkalendarit.

Projektkalendari përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seancë plenare. Në këtë draftkalendar janë parashikuar tri seanca plenare, përkatësisht në datat: 4 korrik, 11 korrik dhe 18 korrik 2019. A ka ndonjë sugjerim për projektkalendarin apo për projektprogramin?

Po, fjala për ju, zoti Manja.

Ulsi Manja – Zoti Kryetar,

Në lidhje me tri institucionet që nuk kanë raportuar ende, janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve. Raportimi i Këshillit të Ministrave në lidhje me zbatimin e politikave të shërbimit civil. Natyrisht, ne mund ta bëjmë gati për muajin korrik, por, nëse nuk e realizojmë dot për seancën e datës 4 korrik, kështu mund ta bëjmë gati për seancën e datës 11 korrik.

Për sa u përket dy institucioneve të tjera, Këshillit të Lartë të Gjyqësorit dhe Këshillit

të Lartë të Prokurorisë, në fakt, arsyeja pse nuk i kemi thirrur që të raportojnë ka të bëjë me kohëzgjatjen e veprimtarisë së këtyre dy institucioneve, nëse do të keni parasysh se ata vetëm në muajin janar kanë filluar nga puna. Sipas ligjit, ata raportojnë jo më pak se dy herë në vit në Komisionin e Ligjeve dhe ne kemi menduar që këto dy institucione, për shkak edhe të mbylljes së një afati pune prej 6 muajsh, t'i thërrasim të raportojnë në muajin shtator, në mënyrë që të kenë edhe se çfarë të raportojnë. Por, gjithsesi, nëse duhet të bëjmë një seancë raportimi në këtë sesion parlamentar, atëherë ne mund t'i bëjmë gati për datën 18 korrik.

Pra, ne kërkojmë që raportimi i Këshillit të Ministrave të shtyhet për në datën 11 korrik dhe i këtyre dy institucioneve në seancën e datës 18 korrik.

Taulant Balla – Meqenëse është jo më pak se dy herë, patjetër që një seancë do ta bëjnë tani dhe seancën tjetër do ta bëjmë në 6-mujorin e dytë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Në fakt, ligji thotë se këto dy institucione duhet të raportojnë sa herë që i thërret Kuvendi. Ka një pikë të katërt, ku thuhet se Kuvendi mund t'i thërrasë këto institucione për çdo problem, pra në raste të veçanta.

Gramoz Ruçi – Po, kush e do fjalën?

Vasilika Hysi - Zoti Kryetar, kam një pyetje lidhur me Rregulloren e Kuvendit. A do të procedohet në këtë sesion apo jo?

Ne kemi bërë 2-3 herë mbledhje, nuk ka ecur puna me ritëm. Në çdo mbledhje që ka zgjatur më shumë se 2-3 orë është diskutuar vetëm një nen. Kolegët e rinj të opozitës duhet të mësohen me praktikën e punës në grupe pune dhe dakordësojmë dhe ku gjithsecilit i ruhet autorësia kur bën amendamente. Puna përgatitore bëhet jashtë orarit të komisionit, pasi është një gjë serioze dhe nuk mund të luhet dhe të sajohen nenet në komision.

Taulant Balla- Mirë do të ishte që kjo punë të kishte përfunduar, sepse është e vetmja detyrë shtëpie që Kuvendi ka për ta realizuar në kuadër të progresraportit të Bashkimit European. Kujtoj këtu që puna e Rregullores ka të bëjë me detyrën e Kuvendit për të transpozuar në Rregullore vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Pra, pavarësisht përpjekjes sonë për të predikuar që ne jemi institucion që respektojmë vendimet e gjykatave, kur bëhet fjalë për vendimet e Gjykatës Kushtetuese ne nuk i kemi ende në Rregullore, por do të ishte mirë që t'i përmbledhnim.

Cilët janë deputetët në grupin e punës?

Vasilika Hysi -Jam unë, Ervin Bushati. Nga grupi demokrat dhe grupi i pavarur nuk kanë kontribuar. Dy duhej t'i caktonte zonja Hajdari, dy duhej t'i caktonit ju si grup i pavarur *(i drejtohet z. Musaj)*.

Taulant Balla- Atëherë, me kë keni punuar ju, se këta nuk paskan sjellë njeri?

Myslim Murrizi– Kemi qenë prezent.

Vasilika Hysi – Nuk kanë sjellë amendamente, domethënë kanë kërkuar kohë dhe ta mendojnë.

Rudina Hajdari – Patjetër që na duhen fasilitete. Duke marrë parasysh që është parlamenti i ri nuk duhet të jemi të çuditur për këtë fakt. Mendoj se duhet të jemi më të ndjeshëm. E kuptoj nevojën, por duhet të jemi më të ndjeshëm ndaj deputetëve të rinj. Nëse i duhet asistencë, nga stafi, jo nga deputetë, se mbase janë politikë.

Vasilika Hysi- Ata duhet të punojnë në grup.

Rudina Hajdari - Mund ta diskutojmë edhe bashkë. Për mua është hera e parë që e kemi ngritur.

Ulsi Manja- Diçka për Rregulloren. Rregullorja nuk është në grup pune. Jemi në fazën e shqyrtimit dhe miratimit nen për nen dhe në Komisionin e Ligjeve kanë kaluar jo pak, por 10 nene. Nuk ka mbetur për grup pune kjo. Ditën e hënë caktojmë rendin e ditës dhe vazhdojmë me nenet që kanë mbetur.

Pra, mbledhja është shtyrë për shkak se unë kam dashur t'iu jap kohë deputetëve të rinj në Komisionin e Ligjeve të japin kontribute shtesë për nenet e mbetura pa kaluar, por kjo nuk ka të bëjë me fazën e grupit të punës e cila ka kaluar para dy vjetësh.

Unë për të qenë korrekt kam thënë që kolegët e rinj deputetë të Komisionit të Ligjeve dhe grupet parlamentare që duan të japin kontribute për pjesën që ka mbetur shtyjmë në kohë, por nuk mund t'i kthehem grupit të punës tani, sepse jemi në fazën e shqyrtimit dhe miratimit nen për nen.

Rudina Hajdari- Mund të ulemi me zonjën Hysi dhe ta zgjidhim.

Myslim Murrizi- Çfarë keni bërë te Rregullorja?

Ulsi Manja – T'i shikojnë, se aty janë.

Taulant Balla – Kemi bërë parimet e Parlamentit Europian.

Vasilika Hysi – Po, dhe është në të mirë të gjithë deputetëve.

Myslim Murrizi- Unë kam kërkuar ta kalojmë më shpejt.

Taulant Balla - Edhe sot kolegët deputetë që përfaqësojnë komunitetin shumë të nderuar çam, në praktikë gjithmonë kërkojnë 1 minutë heshtje, por, ju lutem, edhe kjo të jetë pjesë e Rregullores edhe një praktikë e konsoliduar e parlamenteve të vendeve të tjera, jo çdo deputet ka të drejtë të kërkojë një minutë heshtje, sepse, nëse bëhet kjo, Kuvendi mund të gjendet para fakteve ose...

Kështu që gjithmonë duhet të jetë solemne, duhet të përcaktohet një orë kur duhet të mbahet vetëm nëse ka kaluar nëpërmjet Konferencës së Kryetarëve dhe Kryetarit të Kuvendit.

(Diskutim pa mikrofon)

Nuk jemi kundër, por duhet të jetë gjithmonë diçka që të jetë salla plot.

(Diskutim pa mikrofon)

Nimet Musaj – Falënderoj zotin Balla dhe mbështetjen që keni dhënë ju si maxhorancë ndër vite për një nga çështjet më të ndjeshme për atë komunitet prej nga vij edhe unë personalisht! Faleminderit që na keni mbështetur dhe na keni dhënë fjalën për të përkujtuar këto ngjarje të mëdha! Faleminderit edhe për sot që edhe unë personalisht brenda asaj kohe kam dhënë mesazhe që i takojnë jo vetëm këtij komuniteti, por edhe shqiptarëve. Në të ardhmen, edhe në zbatim të Rregullores, shqetësimet që kemi t'i bëjmë brenda parametrave që duhen.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Ka dikush diçka tjetër për të shtuar?

Rudina Hajdari – Zoti Kryetar, dua të bëj një koment shtesë nëse është e mundur, që mund të jetë jashtë rendit të ditës: kohët e fundit kam ndjekur me shumë shqetësim faktin që ka pasur disa ndryshime të futura në projektligje, siç është rasti i fundit, neni i shtuar te Kodi Penal, që erdhi në mënyrë tinëzare në orën 7 të darkës, në Komisionin e Ligjeve pa u shqyrtuar më parë me opozitën. Këtë shqetësim do ta ngre edhe në seancën plenare, sepse dua të shikoj sa i përshtatshëm është ky projektligj dhe nëse është në përputhje me Kushtetutën, po ashtu edhe me të drejtat ndërkombëtare të njeriut.

Këto janë disa çështje shumë shqetësuese dhe ju, si Kryetar i Kuvendit, duhet t'i shikoni

me vëmendje, pasi parlamenti po humb funksionalitetin e vetë. Pavarësisht se kemi ardhur në parlament, sidomos ata deputetë që kanë zëvendësuar deputetët e mëparshëm, jemi nën tryzni, jemi një gjysmë parlamenti, të themi, por nga ana tjetër të mos ta përdorim dhe ta shfrytëzojmë këtë rast, sepse nuk do të dukemi mirë as në sytë e shqiptarëve dhe as në sytë e aleatëve tanë, që e ndjekin nga afër kalendarin tonë dhe çdo projektligj që kalojmë. Ata shohin që këto projektligje shpesh po përdoren politikisht për një axhendë afatshkurtër.

Ne duhet të bëjmë projektligje afatgjata për Shqipërinë dhe shqiptarët, të cilat nuk i shërbejnë vetëm kohës së tanishme, por do të shërbejnë edhe në të ardhmen.

Uroj t'i shikoni me më tepër shqetësim këto çështje dhe të kërkonit më shumë llogaridhënie prej nismëtarëve, deputetëve, të cilët bëjnë propozime pa u konsultuar me opozitën, me faktorët ndërkombëtarë dhe me shoqërinë civile e të tjerë. Nuk mund të bëhen propozime të tilla kaq kalimthi.

Po jua ngre juve si shqetësim, zoti Kryetar, sepse mendoj se mbani përgjegjësinë kryesore në këtë legjislaturë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Mund të më jepni një shpjegim si qëndron problemi?

Taulant Balla – Zoti Kryetar, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, brenda çdo afati të përcaktuar nga Rregullorja, bëhet fjalë për një projektligj, bëhet fjalë për një proces shumë të zgjatur dhe të hapur për diskutimin e ndryshimeve në Kodin Penal, ku janë bërë mjaft rregullime shumë të rëndësishme të politikës penale në Shqipëri. Madje, ju kujtoj këtu, që ka një nismë prej rreth 35 mijë zgjedhësish shqiptarë, e cila priste prej 2 vjetësh në Kuvendin e Shqipërisë dhe i është bashkëngjitur kësaj. Por, duhet të mos harrojmë që kemi bërë një punë të shkëlqyer sa i takon dhunës nëpër stadione, dhunës kundër mjekëve, mbrojtjes së tyre nga dhuna, si dhe kemi një nismë të 2 deputeteve zonja për kërcënimet që u bëhen motrave, vajzave tona në rrjetet sociale.

Pra, ju lutem, një sekondë ta mbaroj fjalën!

Rudina Hajdari – Këto gjëra ekzistojnë gjithandej, zoti Balla, prandaj, ju lutem, mos bëni sikur shqetësimi më i madh që po kalon gjithsecili prej nesh është një shumë personale...

Taulant Balla – Respekti ndaj jush më bën..

Rudina Hajdari - ...prandaj nuk do të merremi thjesht se çfarë ndodh me deputetët, por do të merremi edhe me çfarë ndodh edhe me tjerët.

Ju thoni, hajde mbrojmë veten tonë, por nga ana tjetër thoni hajde të ndëshkojmë ata që shkojnë dhe prishin zgjedhjet, ndërkohë që në Kodin Penal, është e parashikuar që ai që ndërhyt në zgjedhje ka bërë një vepër penale. Ti do t'ia heqësh të drejtën atij të udhëtojë jashtë shtetit?

Taulant Balla – Unë nuk e di ku e gjeni të drejtën të më ndërprisni...

Rudina Hajdari – Më falni, ku e keni gjetur këtë?

Gramoz Ruçi – Po diskutojmë për përmbajtjen...

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Hajdari, keni ndonjë gjë për procedurë, sepse përmbajtja dhe vota janë gjë tjetër.

Taulant Balla – Në respekt të procedurës në Komisionin e Ligjeve deputeti Ervin Bushati me të drejtën që i jep Kushtetuta në Republikën e Shqipërisë, një deputet ose 20 000 zgjedhës kanë të drejtë të propozojnë një amendament, ose një ligj...

Rudina Hajdari – Ajo ishte shtesë, nuk ishte amendament...

(Diskutime pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Nga pikëpamja procedurale është propozim në komisionin përkatës.

Ulsi Manja – Kisha diçka nga ana procedurale për ta përmbyllur sa i takon orës 19:00, pse u zhvillua mbledhja në këtë orë.

Komisioni i Ligjeve atë ditë ka pasur dy mbledhje, një mbledhje paradite po për paketën e ndryshimeve në Kodin Penal dhe, duke qenë një pjesë e kolegëve kishin angazhime në zonat e tyre elektorale në pjesën e dytë të ditës, është thirrur mbledhja në orën 19:00, sepse, sipas Rregullores së Kuvendit, paketa e ndryshimeve në Kodin Penal për t'u shqyrtuar sot në seancë plenare do të duhej të respektonte afatin prej 48 orësh për t'u përmbyllur raporti. Kjo ka qenë e gjitha. Dihet fakti që paketa e ndryshimeve në Kodin Penal po diskutohet prej gati 2 muajsh në Komisionin e Ligjeve.

Rudina Hajdari – Ju nuk e keni konsultuar në asnjë moment me opozitën këtë gjë, duke mos i dhënë fare kohë për ta shqyrtuar këtë nen apo këtë amendament që keni shtuar, quajeni si të doni. Kryeministri e ka thënë gjatë fushatës së zgjedhjeve dhe ju e keni vënë pas 1 jave, prandaj ju lutem, të jemi pak më serioz.

Gramoz Ruçi – Kush është nga opozita në komision?

Rudina Hajdari – Asnjë, nuk është konsultuar me asnjë nga ne.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Në shqyrtimin e paketës kanë gjithë të gjithë deputetët...

Taulant Balla – Kanë qenë Ediola, Korabi, Roshi...

Vasilika Hysi – Kanë qenë Alimadhi, Mara, Ralf Gjoni...

Gramoz Ruçi – A kanë pasur ndonjë qëndrim?

Ulsi Manja – Kanë mbajtur qëndrim në lidhje me përmbajtjen e tekstit.

Gramoz Ruçi – Atëherë, konkludojmë që kërkesa që bën kryetari i Komisionit të Ligjeve për raportimin e qeverisë për shërbimin civil të spostohet në datën 11 korrik. Sa u takon organeve të drejtësisë, e vërteta është që ne jemi deficitar si Kuvend, është kuptuar keq pavarësia, mosndërrhyrja e të tjera, sepse mosndërrhyrja është për subjektet politike, për ekzekutivin, por është edhe detyrim ligjor dhe kushtetues kontrolli parlamentar nga organet e reja të sistemit të drejtësisë. Vërtet është një gjë pozitive që në kuadër të funksionit kontrollues parlamenti ka bërë një hap para, sepse më parë nuk raportohesh në këto organe dhe as në komisione, ndërsa tani jo vetëm që kanë kaluar në të gjitha komisionet, por kanë kaluar edhe në seanca parlamentare.

Së dyti, është diçka shumë pozitive që deputetët dhe grupet parlamentare kanë shprehur vullnetin e tyre që të bëhet debat, ndërkohë që në legjislaturat e tjera nuk është zhvilluar asnjë debat për organet e pavarura, por kjo nuk do të thotë që ne nuk kemi deficitar. Partnerët tanë ndërkombëtarë dhe opinioni publik shqiptar pyesin se kur do të bëhet Gjykata Kushtetuese, kur do të ngrihet Gjykata e Lartë, kur do të ngrihet SPAK-u, kur do të ngrihet Byroja e Hetimit dhe kur do të vendoset Prokurori i Përgjithshëm. Në qoftë se ia bëj vetes sime këto pyetje, nuk di t'u jap përgjigje, aq më pak ju. Atëherë, po ne të gjithë si Kuvend ku jemi? Prandaj, kjo punë duhet bërë me shumë përgjegjësi. Sikur kanë gjetur një lloj komoditeti njerëzit, që u kemi dhënë besimin për atje, të cilët trajtohen dy herë më mirë dhe dy herë më shumë sesa Presidenti i Republikës, por absolutisht ata duhet të kenë shqetësimin që ka publiku shqiptar dhe partnerët tanë ndërkombëtarë për këtë vakum objektiv, i cili është realizuar deri tani, sepse kalon në subjektivitet çdo zvarritje e mëtejshme e kësaj çështjeje. Prandaj, këtë gjë duhet ta shikojë me shumë përgjegjësi Komisioni i Ligjeve, i cili duhet të bëjë një mbledhje shumë të përgatitur dhe shumë serioze, me një llogaridhënie nga këto organe, pa i denigruar absolutisht, sepse secili duhet të ruajë sovranitetin e vet, por që në fund rezultati duhet të jetë ky. Ne, si Kuvend, duhet

të dimë dhe nëpërmjet nesh, si të deleguar të sovranit në organin më të lartë të kësaj Republike, duhet të marrim vesh se kur ky vend do të ketë Gjykatë Kushtetuese, kur do të ketë Gjykatë të Lartë, kur do të ketë SPAK-un e të tjerë dhe, secili të bëjë punën e vet. Kjo është përgjegjësia jonë.

Lidhur me Rregulloren e Kuvendit, ju lutem shumë, është bërë Rregullorja ping-pong, ka 2-3 vjet që vjen vërdallë sikur po e bëjmë nga e para dhe do të shpikim rrotën në shqiptarët. E gjithë Rregullorja e Kuvendit tonë është *mot a mot* siç e kanë të gjitha vendet e tjera. Çfarë i mungon asaj?! Së pari, i mungon që Gjykata Kushtetuese ka marrë vendimet dhe ne nuk kemi implementuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese në Rregulloren e Kuvendit, që është domosdoshmëri t'i bëni brenda muajit dhe shembullin duhet ta japim ne.

Së dyti, grupet parlamentare dhe deputetët kanë propozuar të mos kemi 4 seanca në muaj, por 3, një javë të jetë takime me zgjedhësit dhe të jetë në funksion të halleve, problemeve dhe shqetësimeve që ata kanë dhe t'i paraqesim këto shqetësime në seancë, ku është rënë dakord në parim. Atëherë, kjo të sanksionohet në Rregullore. Pra, ne kemi plotësuar Kodin e Etikës në parlament dhe nuk kemi plotësuar kërkesën tjetër për 6 objektivat që kemi pasur në progresraportin e vitin 2018, ku janë 46 masa, një pjesë e të cilave ka mbetur e paralizuar vetëm e vetëm se janë vendosur te Rregullorja e Kuvendit. Kjo për shkak të implementimit të saj. Ja ku e kemi drejtoreshën e seancave, juristët dhe këshilltarët juridikë të mbledhen dhe të vihet në dispozicion të opozitës dhe të deputetëve, të këshillohen dhe të marrë fund një herë e mirë kjo histori.

Lidhur me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, çfarë është bërë me to?

Ulsi Manja – Ato janë objekt shqyrtimi në Këshillin e Legjislacionit...

Mimoza Arbi – A mund të sqaroj, sepse nuk është zoti Fino, se ai e drejton. Është mbledhur Këshilli i Legjislacionit nën drejtimin e zotit Fino, ku opozita ka caktuar një ekspert nga ana e saj dhe është lënë që të punojnë eksperti i caktuar nga deputetët e maxhorancës me atë të opozitës për të riparë edhe një herë projektdraftin.

Gramoz Ruçi – Sa kohë ka kjo?

Mimoza Arbri – Ka 10 ditë. Dje bëra një takim me zotin Fino dhe është lënë që javën tjetër ekspertët të sjellin draftin e përgatitur.

Gramoz Ruçi – Dua të sqaroj diçka, sepse kolegët janë të rinj në Kuvendin e Shqipërisë. Këshilli i Legjislacionit drejtohet një herë në 6 muaj me rotacion nga deputetët, tani

e ka radhën zoti Fino. Me rotacion është drejtuar 2 herë nga ish-deputetët e opozitës. Ky Këshill për këtë pikë është mbledhur dhe pothuajse ka arritur në përfundime në finale. Ne, sa herë ndryshojmë kryetarin, rifillojmë nga e para. Pse rifillojmë nga e para?! Çfarë diskutojmë?! Diskutojmë nëse do t'i implementojmë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, apo jo? Këtë po diskutojmë?! Jemi të detyruar t'i bëjmë. Është me detyrim përcaktim. Çfarë po diskutojmë ne në këtë mes?! Gjykata Kushtetuese ka thënë: “kjo po, kjo jo”. Atëherë, ne do ta shkruajmë, do ta hedhim dhe jemi të detyruar. Nuk mund të dalim ne mbi vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ka 2 vjet kjo histori; është që nga legjislatura e kaluar dhe pak më parë fola me organet e sistemit të drejtësisë. Jam i bindur që do të vinë në parlament apo në Komisionin e Ligjeve dhe do të thonë: “Zotëri, çfarë na kërkon neve”? Gjykata Kushtetuese, ligji që ke miratuar ti, më ka vënë këtë pezullim, unë nuk veproj dot, sepse kam këtë ngërç juridik, prandaj e kam zvarritur punën”. E kuptoni se ku jemi, apo jo?! Nuk mban më uji pilafi për këtë çështje. Edhe unë po të jem kryetari i KED-së, kryetari i KLP-së e të tjera them: “Çfarë kërkon nga ne ju”? Ju keni 2-3 vjet, që keni miratuar paketën ligjore, keni bërë ndryshimet kushtetuese, ka pasur ankesë në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese për këtë nen kërkon llogari, e ka hedhur poshtë, të ka kërkuar riformulim dhe ti, ore zotëri, nuk e ke bërë, nuk e kam bërë unë. Tani çfarë kërkon, duhet të dalim ne para popullit dhe t'u themi: na falni ne deputetëve që jemi zgjedhur, sepse nuk jemi në gjendje për 2 vjet të bëjmë dy nene?! Këto dy nene, janë referuar nga Gjykata Kushtetuese. Ju lutem, kur ulemi në tavolinë, t'i lëmë partitë atje nga kemi ardhur dhe të vendosim, sepse disa gjëra nuk janë punë partish! Të gjithë po betohemi për reformën në drejtësi kur vjen puna për 2, 3, 4 apo 5 nene e pengojmë reformën në drejtësi.

Në lidhje me diçka që u ngrit këtu, ju lutem, duhet vendosur në Rregullore. Nuk ka parlament në botë që çdo deputet ngrihet në sallë dhe, si t'i kujtohet atij, të mbajë një minutë heshtje. Parlamenti është institucion, dhe minuta e heshtjes duhet të ketë një protokoll. Prandaj, duhet ta mendojmë mirë çështjen dhe të themi: parlamenti shqiptar të mbajë një minutë heshtje, për shembull, për deputetë dhe ish-deputetë, për kryeministra dhe ish-kryeministra, për presidentë dhe ish-presidentë, për anëtarë të akademisë së shkencave e të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Njerëz jemi të gjithë dhe do të ndodhin, por jo çdo deputetë ngrihet në sallë, sepse jemi para publikut dhe themi: çfarë parlamenti është ky?! Ngrihet një deputet dhe thotë... Tani janë gjëra të ndjeshme. I vdekuri kushdo qoftë ai, nderohet, nuk diskutohet, por ka një masë. Ju lutem, vendosni një protokoll për këtë çështje, të vendosim diçka në Rregullore, pra të kemi diçka me udhëzim të brendshëm apo me Rregullore, që, sa herë ka raste të tilla, të mblidhet

Konferenca e Kryetarëve. Kur them Konferenca e Kryetarëve, 4 kryetarë grupesh janë. Të mbledhen dhe të thonë: për ngjarjen që ka ndodhur, për shembull, është një ngjarje historike, do të vendosim që në këtë orë do të mbahet kjo minutë dehe të mos ndodhemi përpara të papriturave, sepse kini parasysh: për një çështje që parlamenti absolutisht nuk duhet ta mbajë, por, nga ana tjetër, thuhet: ti e propozon, je i mirë; parlamenti nuk e mban. Kini parasysh që ai ka njëmijë njerëz nga mbrapa; këta nuk dinë as kodin e vdekjes! E kupton? Është delikate çështja edhe në planin human e njerëzor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lidhur me Kodin Penal, ju lutem shumë, kini parasysh që çdo deputet ka të drejtë, sepse e ngriti zonja Hajdari, që ka qenë në program, ka qenë në kalendar e të tjerë... Ky nuk është një projektligj më vete që të ndjekë procedurat parlamentare: nisma duhet të qëndrojë 15 ditë, pastaj të futet në program, pastaj në kalendar, pastaj të kalojë në komisione. Por, nga ana tjetër, kur diskutohet një Kod ose një projektligj, çdo deputet në komision, deri te salla e Kuvendit, ka të drejtë që para 24 orëve të depozitojë amendime. Votohet ose jo, është diçka tjetër. Kështu që nuk kemi çfarë të bëjmë. Dua të trajtoj edhe diçka tjetër lidhur me këtë. Ka shtete, madje të Bashkimit Europian, që pjesëmarrjen në votim e kanë detyrim.

Së pari, në qoftë se ti nuk merr pjesë në votime, të ndalohej dalja jashtë shtetit.

Së dyti, shikoni se çfarë po bëhet me ne si shqiptarë. Për arsye të pesë vetave, të njëqind vetave apo të njëmijë vetave, që kryejnë krime në vendet e Bashkimit Europian, kërkohet të penalizohen 3 milionë shqiptarë për të mos lëvizur jashtë shtetit. E qartë? Prandaj, kur ne flasim për përgjegjësi shtetërore, duhet të marrim masa që liritë dhe të drejtat e njeriut të mos jenë pa fund dhe për këdo. Ato janë për pakicën, për atë pakicë që dëmton shumicën, ka penalitete dhe ne duhet të përgjigjemi për këtë punë. Mos harroni që jemi i vetmi shtet që ka nënshkruar kontratë me FRONTEX-in për të kontrolluar kufijtë. Pse? Sepse jemi bërë si delja e zezë, sikur ne shqiptarët e futëm edhe në Europë, edhe në botë, krimin, korrupsionin, drogën e njërën, tjetrën dhe këtë, pas shqiptarëve fshihen të tjerët. Por ne jemi shteti që aspirojmë Bashkimin Europian, shikohemi me lupë. Ka që na duan, ka që nuk na duan. Ata që nuk na duan, thonë: “Ja, krimi shqiptar; kriminelit shqiptar!” Por ne nuk kemi pse të penalizojmë një vend, një shtet, një popull të tërë për shkak të individëve të veçantë!

Ka pyetje?

Myslim Murrizi – Te Rregullorja e Kuvendit, a është përfshirë trajtimi i deputetëve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taulant Balla – Trajtimi i deputetëve është te ligji “Për statusin e deputetit”.

Myslim Murrizi – Është te statusi, apo te Rregullorja?

Ulsi Manja – Kjo çështje përfshihet te ligji “Për statusin e deputetëve”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Nuk ka lidhje me Rregulloren.

Myslim Murrizi – A do të ndryshojë?

Vasilika Hysi – Zoti Murrizi, në Rregullore, Byrosë i është dhënë kompetenca për të përcaktuar me vendim mënyrën e trajtimit financiar e të tjera.

Myslim Murrizi – Ku bëhet kjo?

Vasilika Hysi – Te Rregullorja.

Myslim Murrizi – Pra, është në Rregullore, apo duhet ndryshuar statusi i deputetit?

Taulant Balla – Në Rregullore është çelësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Jo, tani e mbyllëm! Atëherë me propozimet për ndryshime që u bënë në kalendarin 3 javor të punimeve të Kuvendit për muajin korrik 2019 dhe për të cilat pati dakortësi në mbledhje, e mbylлим këtë diskutim.

Programi dhe kalendari do t’i njohtohen deputetëve në seancë plenare.

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA